

UNDEF

The United Nations
Democracy Fund



FNUD

Fonds des Nations Unies
pour la démocratie



**Raport mbi realizimin e
premtimeve elektorale të
z. Gjon Gjonaj, Kryetari i
Bashkisë Pukë**

PROJEKTI

**“Ndjekja dhe verifikimi i
premtimeve të fushatës
zgjedhore në Shqipëri”**

Mbështetur nga:

**Fondi për Demokraci i Kombeve të
Bashkuara**

Për më tepër informacion vizitoni platformën online “Matësi Elektorale” (The Albanian Truth-o-Meter Platform):

www.matesielektor.al

Ju mirëpresim të kontribuoni me ide dhe sugjerime mbi shpenzimet/investimet buxhetore lokale apo të qeverisjes qendrore si dhe mbi premtimet elektorale të realizuara ose të perealizuara të të zgjedhurve lokalë dhe anëtarëve të qeverisë.

E-mail: rdakorca@gmail.com

Tel: + (355) 822 42626

Premtimet elektorale të z. Gjon Gjonaj, Kryetari i Bashkisë Pukë

1. Objektivi im madhor është që në katër vitet Puka të shndërrohet në një qytet të zhvillimit të turizmit gjithëvjetor;
2. Mbështetje financiare për projektet më të mira nga të rinjtë që merren me zhvillimin e turizmit në bashkinë e Pukës;
3. Taksë zero për vitin e parë të çdo aktiviteti në fushën e turizmit;
4. Në 4-vjeçarin e ardhshëm do të bëhet rivitalizimi i liqenit të Kukajve dhe lidhja e dy liqeneve me infrastrukturë urbane;
5. Këndi i lojërave të aventurës për të rinjtë.

Burimi: <https://ata.gov.al/2019/06/24/puke-gjonaj-takse-zero-per-vitin-e-pare-te-cdo-aktiviteti-ne-fushen-e-turizmit/>

Premtimet e arritura

1. Rehabilitimi i digës së Rezervuarit të Kukajve.
2. Rehabilitimi i kanalit vaditës në fshatin Qerret, Nj. Adm. Luf – Qerret, i cili bën të mundur përmirësimin e sistemit vaditës të kësaj zone.
3. Ndërtimi i urës auto në fshatin Kabash, Nj. Adm. Rrapë.
4. Hapja dhe sistemimi i rrugës nga Kisha e “Shën Palit” në qendër, e më tej në drejtim të lagjes Breg.
5. Rikonstruksioni i Krojit të Zojës, Nj. Adm. Rrapë.
6. Rikonstruksioni dhe plotësimi i platformës pluskuese në liqenin piktoresk të Pukës.
7. Rikonstruksioni i Urës së Lajthizës në fshatin Gjegjan, Nj. Adm. Gjegjan.
8. Ndërtimi i lulishtes së re në qendër të qytezës së Lufit duke krijuar një mjedis çlodhës dhe argëtues në portën hyrëse të qytetit të Pukës.
9. Mbjellja e 1000 fidanëve pishë e zezë në territorin e Njesisë Administrative Qelëz.
10. Vendosja e ndriçimit publik në qendrën e Njesisë Administrative Rrapë.
11. Vendosja e ndriçimit publik LED në qendrën e Njesisë Administrative Luf – Qerret.
12. Rikonstruksioni dhe pajisja me orenditë e duhura për Qendrën Komunitare pranë Bashkisë Pukë.
13. Pastrimi dhe sistemimi i varrezave në qytetin e Pukës si dhe në fshatrat e Njësive Administrative.
14. Hapja, rehabilitimi i rrugëve, si dhe vendosja e ndriçimit publik LED në fshatin Qelëz, Nj. Adm Qelëz.
15. Ka përfunduar riveshja me asfalt e unazës së qytetit të Pukës.
16. Rikonstruksioni i plotë i Qendrës Shëndetësore Luf – Qerret.
17. Instalimi i ndriçimit LED në unazën e madhe të qytetit të Pukës, në rrugën kryesore, në rrugën pas bankës, si dhe në lagjen e muzeut, pjesë e bllokut nr. 2 të qytetit.
18. Pastrimi i të gjitha tobinove të bllokuara në të gjithë territorin e Njesisë Administrative Rrapë.
19. Rikonstruksioni i urës këmbësore si dhe asfaltimi i rrugës në lagjen Kukaj.

20. Ndërtimi i rrjetit vaditës në lagjen Lajthizë të fshatit Gjegjan, Nj. Adm. Gjegjan.
21. Ka përfunduar riparimi i urës këmbësore mbi lumin Fan që lidh fshatrat Rras dhe Kuzhnen në Njësinë Administrative Gjegjan.
22. Ka përfunduar vijëzimi i rrugës kryesore si dhe i gjithë rrugëve brenda qytetit të Pukës.
23. Rehabilitimi i trasesë së aksit rrugor Kalivare – Kimëz, Nj. Adm. Gjegjan.
24. Rikonstruksioni i Qendrës Shëndetësore Gjegjan (Ambulanca Kimëz) Nj. Adm. Gjegjan.
25. Rikonstruksioni i Qendrës Shëndetësore Qelëz (Qendër).
26. Rikonstruksioni i Unazës së qytetit të Pukës, që do të zgjidhë përfundimisht problemin e qarkullimit të mjeteve.
27. Ka përfunduar rikonstruksioni i të gjitha traseve të urave këmbësore në Njësinë Administrative Luf – Qerret.
28. Pastrimi dhe sistemimi i mjediseve të jashtme të shkollave në Njësinë Administrative Gjegjan.
29. Vendosja e ndriçimit publik në rrugën Zezaj.
30. Hapja dhe sistemimi i rrugës së lagjes “Sutaj” në fshatin Korthpulë, Nj. Adm. Qerret.
31. Ka përfunduar sistemimi i skrapatës buzë liqenit të qytetit, duke e transformuar atë në një tjetër hapësirë çlodhëse.
32. Hapja dhe sistemimi i kanaleve vaditëse të tokave bujqësore në lagjen “Bacaj” të fshatit Gojan i Vogël, Nj. Adm. Gjegjan.
33. Krijimi i një hapësire të gjelbër dhe i një këndi pushimi tek kompleksi i pallateve pranë Bashkisë Pukë.
34. Ndërtimi i urës së re mbi përroin e Rrvishtit në fshatin Midhë, Nj. Adm. Qelëz.
35. Asfaltim, ndërtim trotuaresh, vendosje e ndriçimit publik dhe ndërtimi i kanalit të ujërave të zeza në qendrën e Gjegjanit.

Premtime pjesërisht të arritura (në proces)

1. Vijon puna për shtimin e sipërfaqeve pyjore ku 5000 fidanë pishë e zezë i shtohen fondit pyjor të Pukës.
2. Vijon puna për riparimin e mureve mbajtëse në lagjen pas Bashkisë Pukë, ku në pak ditë do të rindërtohen pjesët e dëmtuara të këtyre mureve, teksa po punohet dhe për fugaturat duke i kthyer jo vetëm funksionale, por dhe dekorative.
3. Vijon puna për shtrimin me pllaka të shëtitores së liqenit në qytetin e Pukës.
4. Drejt përfundimit traseja e re e rrugës Pukë – Kabash.
5. Në segmentin rrugor Mjedë - Pukë - Fushë Arrëz - Fushë Dukagjin, kanë filluar punimet për përmirësimin e shtresave asfaltike duke rritur sigurinë rrugore dhe duke përmirësuar qarkullimin e mjeteve.
6. Po shkon drejt finalizimit rikonstruksioni i pallatit të ish NSHN-s në qytetin e Pukës. Godina i shtohet kompleksit të ndërtesave sociale, ndërtuar disa metër larg këtij pallati.
7. Ka nisur puna për rehabilitimin dhe rikthimin në funksion të segmentit rrugor Mardhnaq – Meçe.
8. Vazhdon puna për ndërtimin e qendrës së grumbullimit dhe përpunimit të produkteve bujqësore në Pukë.

9. Vijon me ritme të shpejta puna për Ujësjellësin e ri të Lufit. Ujësjellësi i ri do të lidhet përmes një linje me depon qendrore të qytetit të Pukës, përmes së cilës do të garantohet furnizimi 24 orë me ujë i kësaj zone.
10. Një investim i rëndësishëm ka nisur në shërbim të qytetarve të Pukës me objekt: "Optimizimi i Rrjetit të Ujësjellësit të Qytetit Pukë" Ky investim do të sistemojë me matje konsumatorët familjarë dhe jofamiljarë në qytetin Pukë dhe lagjet periferike. Investimi përfshin:
- Sistemimin e dy linjave të transmetimit në lagjen Zezë Pukë.
 - Sistemimin e linjës shpërndarese të lagjes me tubacion PE.
 - Sistemimin e linjave të gjithë abonentëve familjarë dhe jofamiljarë me tubacion PE, puseta, kolektore, ujëmatësa për çdo konsumator familjarë dhe jofamiljarë.
 - Sistemim me ujëmatësa në bokse i gjithë abonentëve familjarë, ente private, enteve shtetërore në të gjitha pallatet e qytetit Pukë.
 - Rrethim i depove 800 m³ dhe 400 m³ Mehaj Pukë me mur guri, shtylla inoksi, rrjet grabion cilësore me lartësi 2.5 m, ndriçim cilësore led, paisje me sistem kamera, sistemim me ujëmatës në hyrje dhe dalje të Depos 800 m³, sistemim me saraçineska komandimi të reja të përmirësimit të sistemit të komandimit dhe kryerjes së veprimeve teknike në depo.
 - Sistemim në matje me linja të reja shpërndarese për çdo abonent familjar dhe jofamiljar në puseta me kolektorë dhe ujëmatësa, në lagjet Mehaj, lagje e Re, Laçaj dhe Kukaj.

Burimi: <https://www.facebook.com/profile.php?id=100064645183888>